



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROSEVAC

NË EMËR TË POPULLIT

Më
Data

04. 06. 20 18

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, me gjyqtarin Ilir Bytyqi dhe me procesmbajtësen Kadishe Shabani, zyrtare ligjore, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDACTED] nga [REDACTED], për shkak të veprës penale shpërdorim i pasurisë së huaj nga neni 330 par. 1 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.nr.1739-7/16, e datës 24.05.2017, pas mbajtjes së seancë së shqyrtimit gjyqsor publik me datat 14.11.17, 23.11.17, 27.12.17 dhe 02.02.18 në praninë e përfaqësuesit të akuzës – prokurorit, Valdet Avdiu, të dëmtuarit [REDACTED] dhe [REDACTED] si dhe të akuzuarit [REDACTED] me avokatin mbrojtës [REDACTED], me datën 02.02.18 mori dhe komunikoi këtë, kurse me datën 15.02.2018 e përpiloi me shkrim këtë;

AKT GJYKIM

I akuzuari: [REDACTED] i lindur më [REDACTED], me vendbanim ne Rr. "[REDACTED]" nr. [REDACTED] në [REDACTED], nga i ati [REDACTED] dhe nënës [REDACTED] e vajzërisë [REDACTED], i pamartuar, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

1. Se me datën 05.07.2016, në Ferizajt, i pandehuri me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobis pasurore, në atë mënyrë që e dëmtuara [REDACTED] ai jepe veturën e markës Reno Kango, mgjyrë e kuqe, me targa të regjistrimit [REDACTED], për ta dërguar te auto mekaniku për rregulliin e një defekti, i pandehuri e merr veturën dhe nuk e k'then më, por e shetë në shumë prej 900 euro /nëntëqind/.
2. Se gjatë muajit Korrik të vitit 2016, saktësisht në bancesën e të dëmtuarës [REDACTED], i pandehuri me qellim të përfitimit të kundërligjshëm pasurosë, nga banesa e saj merr dy telefona mobil një Iphone 5 dhe një Iphone 6, vlera e të cilëve është 1000 euro /njëmijë/, stoli ari dy unaza dhe një varëse të qafës në vlerë

prej 500 euro /pesëqind/, të cilat më pasi i ka shitur si dhe i ka marrë para të gatshme sipas të dëmtuarës në shumën prej 4000 euro /katërmijë/.

me të çkëtë kreu veprën penale në vazhdim shpërdorim i pasurisë së huaj nga neni 330 par. 1 të të KPRK-së.

Në bazë nenit 330 par. 1 dhe neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42, 46, 49, 50, 51, 52, 62, 73, të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarin e

G J Y K O N

Dënim me burg në kohëzgjatje prej 5 /pesë/ Muaj, të cilin dënim do ta vuaj pasi aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.

dhe

Dënim me gjobë në lartësi prej 500 euro /pesëqind/, të cilin gjobë obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditëve, pasi aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me nenin 46 par. 3 të KPRK-së, do të ekzekutohet në atë mënyrë që të pandehurit për çdo 20 Euro, do të vuaj 1 /një/ ditë burgim.

E dëmtuara, [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR], për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest juridiko-civil.

Në bazë të nenit 450 dhe 451 të KPPK-së, gjykata të akuzuarin e obligon që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 50 euro /pesëdhjetë/, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.

Detyrohet i akuzuari që për kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 Euro /tridhjetë/, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m i

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale te paraqitur për gjykim, çmoi se çështjaeshte ne juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet te realizohet perparakesaj gjykate. Po kështu është ne kompetencën lëndore dhe teritoriale te kësaj gjykate, pasi vepra penale për te cilën është proceduar te pandehurit gjykohet nga gjyqtari individual dhe vendi ku është kryer ose tentohet te kryhet vepra penale.

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka sjellë për gjykim çështjen penale sipas akuzës PP.nr.1739-7/16, e datës 24.05.2017në ngarkim të pandehurin [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR], për veprën penale në vazhdim shpërdorim i pasurisë së huaj nga neni 330 par. 1 të KPRK-së, dhe në shqyrtimin gjyqësor respektivisht në fjalën perfundimtare ka propozuar që të pandehurit ti shqiptoj nje sanksion penal të parapar me ligj.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale mbajti shqyrtimin gjyqësor 14.11.17, 23.11.17, 27.12.17 dhe 02.02.18 në të cilën përfaqësuesi i akuzës-prokurori i shtetit, lexoj aktin akuzues, dhe gjyqtari pasi që u bind se i pandehurit e ka kuptuar akuzën, konform nenit 325 par. 1 të KPPK-së, të pandehurit iu ofroj mundësinë të pranojnë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

I akuzuarit [REDAKTUAR] në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale e cila iu vihet në barrë.

Pasi qe i akuzuari nuk e ka pranuar fajsinper veprën penale sipas kësaj akuze, Gjykata ka bere paqazitjen e provave dhe pas vlersimit te tyre nje nga nje dhe duke i ndërlidhur reciprocikisht njërën me tjetern, ne kuptim te nenit 361 par. 1 dhe 2 te KPPK-së, vërtetoj gjendjen e fakteve te përshkruar hollësisht ne dispozitivin e këtij aktgjykimit:

Mbrojtja e të akuzuarit

I akuzuari në fillim të shqyrtimit gjyqësor nuk ka pranuar fajësinë për veprat penale sipas dispozitivit të aktakuzës, duke pohuar se të dëmtuarën [REDAKTUAR] e njef dhe fillimisht ka pasur raporte kolegjiale pasi kanë punuar për rreth pesë /5/ muaj në restorant Montana në fshatin Prelez K. Ferizaj, më pas i pandehuri ka ndërprerë punën për faktin se në një konflikt të bërë në at restorant është plagor me armë. I pandehuri me tutje tregon se një natë (pa specifikuar), ka shkuar në restorant Italia dhe aty ka vëre re të dëmtuarën duke punuar dhe se e dëmtuara ti ketë shkruar në face book “pse ke ardhur këtu” ky nga ky rast kanë filluar lidhjen dhe vetëm pas tri jave janë njoftuar familjarisht dhe gjatë një viti kanë bashkëjetuar në një banës me qira ne Ferizaj, nuk qendon se i kam marrë dy telefona një Iphone 5 dhe një Iphone 6, këtë të fundit e dëmtuara ai ka dhënë bakshish, ndërsa vetura Reno Kongo nuk ka qenë në pronsi dhe emër personal të [REDAKTUAR] dhe këtë vetur e kishte marrë marrë në shfrytëzim nga një shokë

I akuzuari një pjesë të mbrojtjes së tij e ka përqëndruar në shpjegimin se së bashku me të dëmtuarën janë dakurduar që veturën ta shesin pasi që ju nevojiteshin paratë edhe përkundër asaj se i pandehuri e ka ditur se vetua në fjalë është e e ish të fejuarit të Fitores, i pandehuri vetë e konfirmon siseturën në fjalë ai ka shitur personit [REDAKTUAR] në shumë prej 900 euro /nëntëqind/, pastaj [REDAKTUAR] e ka lajmëruar [REDAKTUAR] se ia kamë shitur veturën dhe se me [REDAKTUAR] ky fare nuk ka pasur kontakt lidhur me veturën, nërsa sa i përket dy unazave dhe një varse qafore nuk qendor se ai kam marr.

I akuzuari më tutje gjatë mbrojtjes së tij ka pohuar se ka dhenë dy deklarata në polici si dhe në prezantimin nga ana e prokurorit të shtetit konfirmon nënshkrimet e tij dhe qëndron paran aty deklaratave të dhenë me datën 08.09.2016 dhe 19.09.2016, po ashtu as para nuk i kamë marrë fare.

Vlerësimi i mbrojtjes së të akuzuarit

Mbrojtja e të akuzuarit gjatë procedurës hetimore e po ashtu edhe në fazën e shqyrtimit gjyqësor është përqëndruar në paraqitjen e mbrojtjes së tij se nuk ka kryer veprat penale në fjalë, por megjithatë nuk e ka kontestuar faktin se me të dëmtuarën janë njoftur dhe kanë bashkëjetuar për një kohë të shkurtër, po ashtu nuk e konteston faktin se veturën Reno Komgo ai ka shitur [REDAKTUAR] të cilën veturë ka pasë njohuri që nuk është në pronsi të dëmtuarës [REDAKTUAR], se vërtet i pandehuri e ka shpërdorur pasurin respektivisht veturën

është vërtetuar nga e dëmtua e të dëmtuarës [REDACTED] e cila në shqyrtim gjyqësor dhe në prezenc të të akuzuarit ka vërtetuar se veturën në fjalë ia ka dhënë për ta dërguar tekë automekaniku për rregullimin e një defekti që është parasqirur gjatë shfrytëzimit të veturës nga ana e [REDACTED] dhe po atë vetur mos të ai k'then pronarit me defekt, mirëpo kur e dëmtuara ai kërkonte veturën i pandehuri u arsyetojke se ende veturën nuk e ka rregulluar mjeshiti sepse nuk po mundet me gjete pjesën që kishte për ta rregulluar, desisa pas një jave prapë i pandehuri ju ka paraqitur të dëmtuarës duke i thënë se do ta kesh gati të Hënen (i bije pas një jave nga koha kur e kishte dërguat te mekaniku), e dëmtuara duke u bazuar në këtë e njofton pronarin e veturës se do tja sjell po ashtu veturën në Prishtinë edhe përkundër kësaj i pandehuri fare nuk ia sjell veturën dhe e dëmtuara e lajmëron në polici të pandehurin ndërsa ky i fundit vetëm i kishte dërguar [REDACTED] një sms me përmbajtje se “jemi gati tu u feju, mos i trego asaj kerrin e kam lënë në fajde” edhe përkundër kësaj vetë personalisht [REDACTED] e kishte njoftuar se veturën Reno Kongo e kishte bler nga [REDACTED] dhe nëse dëshiron të ia k'thej duhet di kompenzoj shumën që i kishte paguar [REDACTED].

Po ashtu sa i përketë kësaj edhe dëshmitari respektivisht i dëmtuari [REDACTED] ka vërtetuar faktin se i pandehuri nëpërmjet telefonit i kishte thënë se veturën pik up (renp kongo), e kishte lënë pengë e mos ta dinë [REDACTED] dhe ne të dy ta gjejm n[jë kompromis për të ia kompenzuar veturën të dëmtuarit [REDACTED].

Sa i përket pjesës tjetër të mbrojtjes se i akuzuarit nuk i ka marr dy telefona mobil një Iphone 5 dhe një Iphone 6, stoli ari dy unaza dhe një varëse të qafës, të cilat më pasi i ka shitur si dhe para të gatshme ia ka merr (sipas të dëmtuarës në shumën prej 4000 euro katërmijë), gjykata e vërtetoj nga e dëmtuara po ashtu nga e dëmtuara [REDACTED] e cila në mënyrë bindëse dhe objektive dëshmoi për faktet se sendet e specifikuara në pikën dy të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që e dëmtuara një ditë së bashku me nënën e saj ishin duke shkuar në një dasem, varsen e qafës dhe dy unaza i ka vendos në tavolin në banës ndërsa i ka marrë një palë komplete të tjera svarofski që ti përdor në at darsëm, në ndërkoho të pandehurin e ka porositur qe të ia vërtetoj nëse i ka lënë tavolin apo në një çant pasi nuk po mund ti gjenë (një çelës kopje të banesës e k pasur i pandehuri), ndërsa i pandehuri i thotë se nuk qenkan, pas kësaj e dëmtuara me tu k'thyer nga dasma e ka kontrolluar gjithë banesën por nuk ka mundur ti gjejë, nërsa i pandehuri [REDACTED] e ka dërguar te argjentari ku i kishte shirur ato sende, mirëpo argjentari i ka treguar të dëmtuarës se arin e kishte shkrirë.

Pra i akuzuari në mbrojtjen e dhënë në shqyrtim gjyqësor është shumë konfuz në raport edhe me deklaratat e dhëna në hetuesi, për çka edhe prokurori i shtetit e ballafaqoi me

e datës 19.09.2016, ku fillon nga rreshti tret "fitorja e kishte marr veturën Reno Kongo me targa regjistrimi 01-936-DD deri te pjesa ku deklarohet se unë e pranoj se veturën e kam shitur pa lejen dhe dijenin e Fitores", mirëpo i pandehuri mbrohet me arsyetim se ka mundësi të ketë harruar se është një kohë e gjatë mirë e ka shitur për punën e fejesës.

Po ashtu prokurori i shtetit e ballafaqon edhe me deklaratën e dhenë në hetuesi me datën 08.09.2016, pjesa pyetje-përgjigje respektivisht në pytjen "se a ja keni marr [REDAKTUAR] një zinxhir ari dhe dy unaza dhe ku i keni lënë? Deri sa në hetuesi është përgjigjur se [REDAKTUAR] vetë ai paska dhënë zinxhirin dhe nazën, ku zinxhirin e ka shitur 45 euro te arxhentari në fund të qytetit ndërsa unazën ia kam k'thyer në banës! Deri sa në shqyrtim gjyqësor është deklaruar se nuk i kujtohet që [REDAKTUAR] i ka dhenë unaz apo zingjirë, pra bazuar edhe në këtë deklaratë i pandehuri mundohet ti bishtrohet realitetit duke prezantuar dëshmi jo të bazuar as në fakte as në prova.

Provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Pasi që i akuzuari nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale sipas kësaj akuze, Gjykata ka bërë paraqitjen e provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njëri me tjetrin, në kuptim të dispozitës së nenit 361 par. 1 dhe 2 të KPPK-ës, vërtetoj gjendjen faktike të përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi:

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar përmes provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë:

- pjesërisht nga mbrojtja e vet të akzuarit;
- përmes dëgjimit të dëshmitarit/dëmtuarit: [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR];
- përmes shikimit dhe leximit të vërtetimit mbi konfiskimin e sendeve të datës 19.09.2016 në emër të pandehurit [REDAKTUAR];
- pjesërisht nga dëgjimi i dëshmitare [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR].

Vlerësimi i provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Fillimisht para se të i vlerësojmë dëshmitë e dëshmitarëve dhe provat tjera materiale është e nevojshme që të qartësohet se gjatë shqyrtimit gjyqësor janë vërtetuar në mënyrë të pakontestueshme faktet në vijim:

- nëse i pandehuri ka përvetësuar në mënyrë të kundërligjshme pasuria e luajtshme të të dëmtueve, fillimisht pasuri e cila i është besuar, e qëllim të jetë që t'i sjell vetes dobi pasurore.
- veprimi me të cilin kryesi ka përvetësuar respektivisht ka shpërdorur pasurinë e të dëmtuarës kryhet kjo vepër penale është përvetësimi i pasurisë së huaj.
- pasuria që i'u ka besuar të pandehurit, ajo vërtet a ka qenë në posedim të atij personi, që do të thotë se nuk guxon të gjendet në posedim të personit tjetër, madje kryerësi a ka mundësi faktike të disponoj me pasuri siç janë përcaktuan në piken I dhe II të dispozitivit të aktgjykimit.

Nga përmbajtja e dëshmisë së të dëmtuaries [REDAKTUAR] në shqyrtim gjyqësor, është vërtetuar se me të akuzuarin është njoftur gjatë vitit 2016 dhe kanë filluar një lidhje dashurie, e dëmtuara po në këtë vit për festën e bajramit ka marrë në shfrytëzim dhe huazim për nevoja familiare një veturë Reno Kango, ngjyrë e kuqe, nga pësoni [REDAKTUAR], gjatë shfrytëzimit të kësaj veture në ndërkohë ju është paraqitur një defekt dhe përr rregullimin e këtij defekti, veturën në fjalë i'a ka dhenë për ta dërguar të automekaniku të pandehurit [REDAKTUAR], në atë mënyrë që mos të i'a k'thej pronarit veturën me defekt, e dëmtuara [REDAKTUAR] i'a kërkon veturën të pandehurit, mirëpo i pandehuri fillimisht i thotë se ende nuk është rregulluar vetura sepse mjeshtri ende nuk e kishte gjetur pjesën të cilën ka patur ta ndërroj, pas një jave (nga dita kur veturën e kishte marrë i pandehuri), i pandehuri i ka thënë të dëmtuarës se të Hënen do ta kesh gati veturën edhe përkundër këtij premtimi veturën nuk i'a ka sjell të dëmtuarës, ndërsa kjo e fundit e njofton pronarin e veturës [REDAKTUAR] edhe njëkohësisht e njofton edhe policinë, në ndërkohë i pandehuri i dërgon një sms pronarit të veturës me këtë përmbajtje "jemi gati tu feju mos i trego asaj se veturën e kam lënë në fajde".

Dëshmitari më tutje vërteton se i pandehuri veturën në fjalë e kishte shitur personit me emrin [REDAKTUAR], për këtë i ka kërkuar edhe llogari të pandehurit mirëpo ky i fundit fare nuk ju ka përgjigjur, për shitjen e veturës e dëmtuara e kishte vërtetar personalisht nga [REDAKTUAR]

pasi që ky i funditë vetë i'a pohon dhe i mundëson që nëse donë ti k'thej veturën të i'a jepe paraq që [REDAKTUAR] kishte paguar atë vetur [REDAKTUAR].

Dëshmitarja më tutje vërteton se i pandehuri i ka marrë edhe një Iphon 5 një Iphon 6, muaji nuk i kujtohet por kjo ka ngjarë gjatë vitit 2016, si dhe dy unaza dhe një qafore (zingjirë qafe), dhe para të gatshme në vlerë prej 4000 euro /katërmijë/, parat i ka pasur të siguruar nga shitja e veturës nga ana e prindit të saj me emrin [REDAKTUAR], për sende e sipërcekura e dëmtuara e ka kuptuar një ditë kur kjo së bashku me nënën e saj ishin duke shkuar në një dasem, zinxhirin e qafës dhe dy unaza e dëmtuara i kishte vendos në tavolinë në banesën e saj, mirëpo i pandehuri pasi ka patur një çelës të banesës, e dëmtuara e thërret dhe e pyet nëse ato sende i kishte lënë në tavolin apo në çantë pasi spo mundet ti gjenë, i pandehuri i thotë se do ti shofë ku gjenden pastaj e thërret dhe e njofton se nuk çenkan, pasi ka përfunduar dasmën e dëmtuara e ka kontrolluar gjith banesën porn nuk ka mundur ti gjejë, pasatj i pandehuri e ka dërguar te arxhentari ku valoni i kishte shitur këto sende, dhe argjentari e ka njoftuar se arinë e ka shkri, ndërsa i pandehuri i pohon se për 350 euro /treqind e pesëdhjetë/ i'a kishte shitur e gjithë arin.

Dëshmitaria ka prezantuar një dëshmi mjaft objektive dhe të saktë, për më tepër dëshmia e tij ishte e plotë dhe besueshmëria e saj rritet se paraqet fakte që ndërlidhen me provat materiale, vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve respektivisht veturën reno kango, ngjyrë e kuqe tabela [REDAKTUAR] e konfiskuar me dt. 19.09.2016, dëshmia e të dëmtuarit tjerer [REDAKTUAR] dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor, si dhe pjesërisht dëshmime të dëshmitarve [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], besueshmëria e dëshmitares [REDAKTUAR] rritet për nga faktet se e njëjta prezantonë dëshmin që konsiston edhe me deklarat e dhenë gjatë hetuesisë dhe një pjesë e sajë dëshmie nuk kontestohen as nga vet i akuzuari.

Nga përmbajtja e dëshmisë së të dëmtuarit [REDAKTUAR] në shqyrtim gjyqësor, është vërtetuar se me [REDAKTUAR] ka qenë e fejuar para pesë viteve (nëse llogaritm nga 2016), gjatë vitit 2016 i ka dhenë në shfrytëzim [REDAKTUAR] veturën Reno Kango, ngjyrë të kuqe, 2 /dy/ ditë para festesë së bajramit, [REDAKTUAR] e ka përdorur për 10 /dhjetë/ ditë këtë vetur, nga kjo e fundit e ka kuptur se veturën e kishte dërguar te mekaniku për ta rregulluar një defekt (zgllob), po ashtu nga e dëmtuara e ka kuptuar se veturën në fjalë e kishte dërguar i pandehuri te mjeshti, ky i dëmtuar i thotë [REDAKTUAR] se defekti në fjalë për dy orë rrehullohet, në ndër kohë i pandehuri [REDAKTUAR] e kontakton me telefon dhe e njofton se veturën e ka lënë në peng ama mos

ta dinë [REDACTED] se ne të dy do e gjejmë një kompromis për ta kompensuar veturën, mirëpo ky dëshmitar fare nuk ka dashur të ketë punë me të pandehurin edhe për kundër asaj që është dëmtuar në vlerë prej 2500 euro se kishte blerë këtë vetur, për të gjithë këtë e njofton edhe [REDACTED].

Dëshmitaria ka prezantuar një dëshmi mjaft objektive dhe të saktë, dëshmia e tij është e plotë dhe e besueshme për faktin se ndërlidhen me provat materiale, vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve respektivisht veturën reno kango, ngjyrë e kuqe tabela [REDACTED] e konfiskuar me dt. 19.09.2016, dëshmia e të dëmtuarit tjerer Fitore Dugolli.

Dëshmitarët [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED], gjatë shqyrtimit gjyqësor të njëjtit dëshmojnë vetëm sa i përketë elementit objektiv të pikës një të dispozitivit mbi bazë të qarkullimit juridik të shitjes dhe blerjes së veturës reno kango, ngjyrë e kuqe, tabela 01-936-DD, e cila vetur ka kaluar nëpër tregtar të veturave për shka edhe pjesa dërmuese janë tregtar te veturave, ndërsa sa përket elementit subjektiv asnjëri nga tre dëshmitaret që e kanë pasur në shfrytëzim dhe posedim veturën nuk vërtetojnë këtë element. Ndërsa për dëshmitaret [REDACTED] dhe [REDACTED], prokurori i shtetit dhe i av. mbrojtësi i të pandehurit propozuan që mos të dëgjohen këta për faktin se të njëjtit janë jo relevant për vërtetimin e gjendjes faktike për ç'ka e ngarkon aktakuza të pandehurin, për të cilin propozim gjykata me aktvendim procedura vendosi të mos i dëgjoj.

Argumentat juridike, interpretimi i dispozites penale referuese dhe konkluzionet e Gjykes.

Për të vlerësuar përgjegjesine penale të të pandehurit në lidhje me vepren penale "shpërdorim i pasurisë së huaj" parashikuar dhe ndëshkuar nga neni 330 par. 1 të KPRK-së, gjykata çmon të nevojshme të analizoje si në vijim:

Me veprimet e tij te kundraligjshme i pandehuri [REDACTED], duke qene i përgjegjshëm para ligjit, me dashje ka kryer veprimet e paligjshme, duke cenuar kështu marrëdhëniet juridike te vendosura për te garantuar sigurimin dhe mbrojtjen e pasurise se tjetrit.

Nga pikepamja objektive të veprës penale i pandehuri [REDACTED] me veprime aktive ka patur si pikësynim marrjen në mënyrë të kundërligjshme të pasurisë veturën e

markës Reno Kango, mgjyrë e kuqe, me targa të regjistrimit [REDACTED], në atë mënyrë i vetëdëshëm për veprimet e veta me dashje direkte shkonë të një tregtar i veturave [REDACTED] e lenë veturën dhe i merre 900 euro /nëntëqind/, gjoja se për ta blerë një dhomë të fjetjes, dhe nëse nuk i'a k'then parat mund ta shetë veturën pra fillimisht i pandehuri e përvetson veturën e huaj pastaj për shumën e sipër cekur e lenë at vetur në formë pengu ose mënyrë shitje sepse ii pandehuri psikikisht e ka lënë peng për mos me i k'thy parat e marra, mënyrën se si e ka bërë këtë sikur të ishte pronar i asaj veture, (shih procesverbanin mbi marrjen në pyetje nga mbrojtësi i vetë të pandehurit si dhe procesverbali i marrjes në pyetje në PK-Ferizaj, në njërën deklarat ka pohuar se veturën e kishte lënë te [REDACTED] dhe i kishte marrë 300 euro, këtë i'a thotë të dëmtuarës pasi e kishte lënë veturën gjoja se do ta rikthen prap veturën, ndërsa në shqyrtimin gjyqësor pohon se edhe e dëmtuara është dakorduar që veturën ta shesin sepse i nevojiteshin parat), pra elementi inkriminues është crucial me rastin e përvetsimit e automjetit e cila manifestohet edhe në formën e shitjes apo lënien e saj peng, do të thotë i është besuar vetura për ta dërguar te automekaniku, e merr veturën në pushtet fizik dhe në fund e lenë peng për 900 euro.

Ndërsa telefonin, Iphone 5 vetë i pandehuri pohon se i'a ka dërgu për servisim sepse gjoja kishte defekt (referuar deklaratës 08.09.16 në PK-Ferizaj), deri sa në shqyrtim gjyqësor pohon se i ka pasdur bakshish nga e dëmtuara, ndërsa telefonin Iphone 6 vetë i pandehuri pohon se e ka marrë dhe shitë për nevoja personale (referuar të njëjtës deklaratë), ndërsa gjatë shqyrtimit pohon se e ka bakshish po nga e dëmtuara, respektivisht i pandehuri pohon se vetë e dëmtuara i ka dhenë zinxhirin dhe një unazë të cilat i ka shitur ke argjendaria në fund të qytetit deri sa unazën kinse e ka k'thyer në banes (referuar të njëjtës deklaratë ku e përshkruar arxhendarin), ndërsa në shqyrtim gjyqësor mohon në tersi, elemente këto tipike të shpërdorimit të pasurisë së huaj e të luajtshme me veprime direkte dhe i vetëdëshëm për pasojat e veprimeve të tij.

Nga ana subjektive, këto veprime janë kryer nga i pandehri [REDACTED] me dashje direkte dhe me qëllimin të përvetësimit të kundërligjshëm për vete të pasurisë së luajtshme të tjetrit, pasi të pandehurit jo vetëm që ka parashikuar pasojat e veprimeve të tyre, por edhe ka dëshiruar ardhjen e tyre, ç'ka rezulton nga tërësia e rrethanave të kryerjes së veprave penale.

Vlerësimi lidhur me dënimin e shqiptuar, kërkesa parurore juridike dhe shpenzimet e paushallit-procedurës penale

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Gjykata të akuzuarit si rrethana lehtësuese i mori parasysh vetëm sjelljen korrekte në procedurë dhe moshën e re, nuk ka aktgjykim që dëshmon se i pandehuri është gjykuar me vendim të formes së prerë, ndërsa si rrethana rënduese gjykata vlerësoj shkallen e përgjegjësisë penale për të pandehurit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, dënimin e shkatuar të dëmtuarës e cila esnjëher nuk është kompenzuar, mënyrën përfide të kryerjes së veprimeve të tij me anë të paraqitjes së rreme të disa fakteve siç ka pohuar se gjoja mekaniku ende nuk e ka gjetur pjesën për ta rregulluar veturën a në fakt vetura vetëm ishte lënë peng, karakteristikat e tij personale i pandehuri vetëm sa është shpall fajtor në shkall të parë për të njëjtën natyrë të veprës penale sipas aktgjykimit **P.nr.2505/2017 dt.14.11.2017**, mbi baze të këtyre rrethanave i shqiptoj dënimin si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Në bazë të nenit 450 dhe 451 të KPPK-së, gjykata të akuzuarin e obligon që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 50 euro /pesëdhjetë/, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.

Detyrohet i akuzuari që për kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 Euro /tritdhjetë/, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.


Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, P.nr.994/17, dt. 15.02.2018

Zyrtare ligjore

Kadishe Shabani

Gjyqtari: **Ilir BYTYQI**



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 dite, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.